

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1	30.06.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore (para datës 01.01.1994)	01.07.2022	Përshëndetje z.....Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin: "Vërtetim për periudha pune në ndërmarrje shtetërore (para datës 01.01.1994)"ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13886 dhe më pas përzgjidhni rubrikën "Përdor". Pasi të kryeni aplikimin, Ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen, por do të mund të merrni atë me vulë dhe firmë elektronike duke klikuar "Dokumentat e Mia" në profilin Tuaj në e-Albania.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
2	30.06.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me	01.07.2022	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti	E deleguar	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		Regjistrimin e Pronarëve Përfitues për shoqërinë shpk		publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni mëposhtë kërkesën e subjektit, të cilët kërkojnë të informohen në lidhje me Regjistrimin e Pronarëve Përfitues për shoqërinë shpk. Problematika e paraqitur më poshtë.S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj.Faleminderit!		
3	30.06.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me raport mjekësor për paaftësi në punë	01.07.2022	Përshëndetje , Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Raporti Mjekësor i aftësisë për punë merret duke u paraqitur tek mjeku i familjes. Ky shërbim nuk mundësohet online në e-albania.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118,nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
4	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me formën e kontratës së qirasë që duhet për rinovimin e lejes së qëndrimit.	01.07.2022	Përshëndetje z.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme, ku Zyra ligjore ".....", të cilë kërkojnë të informohen në lidhje me formën e kontratës së qirasë që duhet për rinovimin e lejes së qëndrimit.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të subjektit ligjor.Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
5	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën për rinovimin e lejes	01.07.2022	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesë suaj për informacion, rinovimi i leje të drejtimit si nje dokument identifikimi mund te behet vetem me paraqitjen e personit fizik bazuar në:	E plotë	Nuk ka

		së drejtimit		<ul style="list-style-type: none"> • Autoriteti lëshues i lejedrejtimit në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), e cila është në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). • Baza Ligjore mbi të cilën mbështetet lëshimi i Leje Drejtimit është Udhëzim i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës Nr. 241/3, datë 19.02.2016 “Mbi karakteristikat e materialit, elementët e sigurisë, elementët grafikë dhe mënyra e plotësimit të lejedrejtimit të ri të mjeteve rrugore”; • Rinovimi i lejedrejtimit bëhet mbi bazën e Certifikatës Mjekësore pas kryerjes së ekzaminimit të aftësive psiko-fizike për të drejtuar mjete me motor. Udhëzimi i sipërcituar ka përcaktuar se Leje Drejtimi lëshohet në Degët e Drejtuesve të Mjeteve të Drejtorive Rajonale në plotësim të çdo specifikë të dhëne në të si dhe duke plotësuar dhe dy elemente sigurie që janë Fotografia Digjitale dhe firma digjitale nga qytetari në aplikim për pajasje me Leje Drejtimi. Këto dy elemente sigurie për momentin nuk mund të arrihen nëpërmjet portalit e-albania. • Rinovimi i Leje Drejtimit është një shërbim që i ofrohet zotëruesit të lejedrejtimit në sportelet e shërbimit të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe për vet specifikat që ka ky shërbim, nuk mund të ofrohet nëpërmjet portalit e-albania . <p>Në lehtësimet e mundësuar nga DPSHTRR në Tiranë, leja e drejtimit tërhiqet në zyrat e shërbimit të ish-NSHRAK, leja e drejtimit tërhiqet brenda 30 minutash. Në drejtoritë e tjera kjo procedurë është lehtësuar në 3-5 ditë pune. Për cdo</p>		
--	--	--------------	--	---	--	--

				pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit,		
6	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me dorëzimin e raporteve të barrëlindjes nga ekonomistja e firmës	01.07.2022	Përshëndetje znj. Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e znj....., e cila kërkon të informohet nëse janë dorëzuar raportet e barrëlindjes nga ekonomistja e firmës? Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të znj...Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
7	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën për rimbursim shpenzime transporti të ndjeri nga jashtë vendit	04.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Suaj për informacion, Ju bëjmë me dije se në rastet kur i njëjti ka ndërruar jetë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Për futjen në vend të kufomave dhe/ose mbetjeve mortore, që vijnë nga shtetet e tjera, i interesuari për transportimin e kufomës duhet të paraqesë, nëpërmjet autoriteteve përkatëse ose personalisht, në autoritetin konsullor shqiptar, në shtetin ku ka ndodhur vdekja: <ul style="list-style-type: none"> • kërkesën për lejen e transportimit të kufomës dhe/ose mbetjeve mortore për në Shqipëri; • certifikatën e vdekjes, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse; • certifikatën e organeve përgjegjëse, që vërteton se janë respektuar të gjitha kushtet sanitare për transportimin e kufomës dhe/ose mbetjeve mortore. Dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga i interesuari me rrugë postare ose me faks.Autoriteti konsullor shqiptar	E plotë	Nuk ka

				lëshon lejen për futjen e kufomës në Republikën e Shqipërisë, me postë ose me faks. Autoriteti konsullor shqiptar njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme, ministrinë që mbulon veprimtarinë e shërbimeve publike dhe prefektin e qarkut ose kryetarin e njësisë vendore ku do të çohet kufoma dhe/ose mbetjet mortore. Në përfundim, pasjetuesi ose i interesuari, dorëzon dokumentacionin pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve të transportit të kufomës. Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit		
8	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin për ID kartë në të njëjtin orar që ka fiksuar takimin për aplikim për pasaportë	04.07.2022	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim të një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Bashkëngjitur gjeni kërkesën e mëposhtme të znj. Pirja, e cila kërkon të informohet nëse mund të aplikojë për ID kartë në të njëjtin orar që ka fiksuar takimin për aplikim për pasaportë. S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga ana juaj. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
9	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin regjistrimi në klasë të parë	04.07.2022	Përshëndetje znj... Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë: Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin: "Regjistrimi në klasë të parë" ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=10117 dhe më pas përzgjidhni rubrikën	E plotë	Nuk ka

				<p>“Përdor”. Gjithashtu, Ju njoftojmë se portali përdoret pasi të keni hapur një llogari në të. Nëse nuk e keni një të tillë, mund ta bëni duke zgjedhur këtë lidhje: https://e-albania.al/Pages/HelpRegister.aspx. Në vijim, për çdo paqartësi apo problem të hasur në përdorimin e portalit e-Albania, mund t’i drejtoheni postës elektronike – helpdesk@e-albania.al – kanal i posaçëm për përdorimin e portalit. Pasi të kryeni aplikimin, Ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen, por do të mund të merrni atë me vullë dhe firmë elektronike duke klikuar "Dokumentat e Mia" në profilin Tuaj në e-Albania. Për çdo pyetje ose paqartësi n’a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
10	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kërkesën për heqje dorë nga shtetësia shqiptare.	04.07.2022	<p>Përhëndetje të nderuar, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Si rrjedhojë, gjëni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme, ku znj....i, e cila kërkon të informohen në lidhje me kërkesën për heqje dorë nga shtetësia shqiptare. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të znj.... Faleminderit!</p>	E deleguar	Nuk ka
11	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë familjare trangu	04.07.2022	<p>Përhëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për T`u pajisur me Certifikatë trangu familjar, duhet të paraqiteni në Zyrën e Gjendjes Civile të arkivave pranë Prefekturës së Qarkut Tuaj. Kjo vlen për të gjitha qarqet, përjashtuar qarku Tiranë. Për Qarkun e Tiranës, procedohet si më poshtë vijon: Për Tirana qytet, do</p>	E plotë	Nuk ka

				paraqiteni pranë Bashkisë Tiranë për tu pajisur me certifikatë trangu.Për fshatrat, do paraqiteni pranë Prefekturës së qarkut Tiranë.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
12	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin e kryer për legalizim prej shumë kohësh	04.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion mbi ecurinë e kërkesës për legalizim, duhet të aplikoni shërbimin:“Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)” përmes platformës qeveritare e-Albania, në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 . Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet. Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania. Për të përdorur shërbimin, klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elektronik.Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij Pavarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin parcelën tuaj ndërtimore. Për shembull: Nëse informacionin zyrtar e kërkoni për qytetin e Tiranës, do përzgjidhni Drejtoria vendore Tirana Veri dhe do vendosni Zonë kadastrale 8110, volum 99, faqe 99. Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit. Numri i referencës së aplikimit do ju ndihmojë për të gjurmuar aplikimin dhe ngarkuar mandatpagesën. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën, ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti	E plotë	Nuk ka

				ose krediti.Pas kryerjes së pagesës në bankë ose postë, duhet që t'i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën. Ngarkimi i mandatpagesës: Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkonti shërbimin e aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin “Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer”. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek “Mesazhet e mia”, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni “Dërgo”.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
13	02.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me veprimet që duhen kryer për aplikimin pajisje me pasaportë biometrike	04.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia.Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku duhet të rezervoni datën dhe orën për t’u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit.Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe pasaportën aktuale që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së ALEAT.Në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të rezervoni në këtë link https://rezervo.aleat.al/ për datën dhe orën e paraqitjes në sportelin ALEAT. Kujdes! Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do ju vijë miratimi i aplikimit tuaj dhe linku për rezervim.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
14	02.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me vërtetim mbi bazën e vlerësuar	04.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë vërtetimin për bazën e vlerësuar duhet të aplikoni në e-albania shërbimin:”Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas	E plotë	Nuk ka

		dhe vërtetim për individ të përgjithshëm		datës 01.01.2012)", ose në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908 . Ndërsa për të marrë vërtetim që nuk keni aktivitet biznesi, do aplikoni shërbimin: "Vërtetim për individ të përgjithshëm", ose në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.noclick_al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11175 . Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
15	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin e kryer për pajisjen me vërtetim për hyrje dalje	04.07.2022	Përhëndetje z....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultoni se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni bashkëngjitur kërkesën e mëposhtme të z...., i cili kërkon të informohen në lidhje me aplikimin për pajisjen me vërtetim për hyrje dalje.Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të z....Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
16	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kalimin e të ardhurave të barrë lindjes	04.07.2022	Përhëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të na dërgoni ID kartë e më pas ta kalojmë kërkesën tek institucioni përkatës.Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E refuzuar	Nuk ka
17	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë kur ka ndryshuar mbiemri	04.07.2022	Përhëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se pasi keni ndryshuar mbiemrin si rezultat i regjistrimit të aktit të martesës, nga llogaria Juaj në e-albania, gjeneroni certifikatë personale apo familjare ku do të figuroni me mbiemrin e ri.	E plotë	Nuk ka

				<ul style="list-style-type: none"> • Certifikatë personale (shqip / në gjuhë të huaj) • Certifikatë familjare (shqip / në gjuhë të huaj) <p>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>		
18	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me vërtetim kontributësh kur shtetasi ka lënë shtetësinë shqiptare	04.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju informojmë se të gjithë shtetasit me leje qëndrimi në Shqipëri duhet të regjistrohen në njësitë Administrative në adresën ku kanë edhe banesën.Me regjistrimin e lejes së qëndrimit pranë Njesisë Administrative, pajiseni me numër identifikimi NID, me të cilin bëni dhe regjistrimin në portalin e-albania. Pas regjistrimit në portal, mund të gjeneroni cdo dokument që është emëtuar gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
19	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me vërtetim kontributësh kur shtetasi ka lënë shtetësinë shqiptare	04.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju informojmë se të gjithë shtetasit me leje qëndrimi në Shqipëri duhet të regjistrohen në njësitë Administrative në adresën ku kanë edhe banesën.Me regjistrimin e lejes së qëndrimit pranë Njesisë Administrative, pajiseni me numër identifikimi NID, me të cilin bëni dhe regjistrimin në portalin e-albania. Pas regjistrimit në portal, mund të gjeneroni cdo dokument që është emëtuar gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit.	E plotë	Nuk ka
20	03.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me regjistrimin e fëmijës	04.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se regjistrimi i aktit të lindjes nuk mundësohet online në e-albania. Për të bërë regjistrimin e fëmijës duhet të paraqiteni pranë Njesisë Administrative duke pasur me vete Aktin e asistencës së lindjes nga spitali, dhe dy letërnjoftimet elektronike të prindërve (kartat e	E plotë	Nuk ka

				identitetit) brenda afatit të vlefshmërisë.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
21	04.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me reset passwordi në portalin e albania	04.07.2022	<p>Përshëndetje,Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal duhet të dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al :</p> <ul style="list-style-type: none"> • foto të kartës ID • emri i nënës • emri i babait • datëlindja e nënës <p>Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit</p>	E plotë	Nuk ka
22	01.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me hapjen e llogarisë në portalin e-albania	04.07.2022	<p>Përshëndetje e nderuar,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se personi mund të hapi llogari personale në e-albania. Nuk është e nevojshme që karta ID të jetë e vlefshme spse për hapjen e llogarisë duhet vetëm nr personal.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit</p>	E plotë	Nuk ka
23	04.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me pajisjen me certifikatë personale, e cila do përdoret jashtë vendit	04.07.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal, në llogarinë tuaj dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin: "Certifikatë personale (shqip / në gjuhë të huaj)" ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38 dhe më pas përzgjidhni rubrikën “Përdor”. Dokumenti</p>	E plotë	Nuk ka

				do ju shfaqet menjëherë, nëse ju duhet në gjuhë të huaj mjafton të klikoni lart në të djathtë. Dokumentat e siguruar nga e-albania kanë të njëjtën vlerë ligjore por nëse dokumenti do të përdoret jashtë vendit duhet noterizuar dhe më pas të legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
24	04.07.2022	Kërkesë për asistencë në lidhje me hapjen e llogarisë në portalin e-albania	04.07.2022	Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni mëposhtë kërkesën e qytetarit për asistencë për një problem në llogarinë e tij në portalin e-albania. Lutemi për një përgjigje drejtuar shqetësimit të qytetarit. Faleminderit!	E deleguar	Nuk ka
25	04.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me aplikimin për regjistrim marke pranë DPPI	05.07.2022	Përshëndetje znj.Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brënda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Si rrjedhojë, gjeni dokumentacionin e studios ligjore, të cilët e kanë kryer aplikimin për shoqërinë "....." shpk me nr kërkesë AL/.....S'a më sipër, lutemi për një përgjigje nga	E deleguar	Nuk ka

				ana juaj.Faleminderit!		
26	04.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me afatin e vlefshmërisë së dokumentave të tërhequra për shpallje martesë	05.07.2022	Përshëndetje i nderuar, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se në ditën e 11(njëmbëdhjetë) pas shpalljes së martesës, të dy partnerët e ardhshëm pajisen me Certifikatë lindje për leje lidhje martesë. Akti i shpalljes së martesës është i vlefshëm 365 ditë, ndërsa certifikatat me shënimin "Për leje lidhje martesë" kanë fuqi ligjore 15 ditë. Kjo do të thote që nëse ju nuk e realizoni lidhjen e martesës brenda 15 ditëve nga dita e 11 - të e shpalljes së martesës, do ju duhet të tërhiqni certifikata të reja pranë zyrave respektive të gjendjes civile.Dokumentat janë të vlefshëm brënda një afati 3 mujor nga dita e tërheqjes së tyre. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit	E plotë	Nuk ka
27	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me regjistrimin e ndërtesës së ndërtuara para vitetve 90	05.07.2022	Përshëndetje znj....Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania.Hyni në portal dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni shërbimin: "Kërkesë për kalimin e pronësisë të objektit pa titull/truallit funksional/oborrit në përdorim" ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14468 dhe më pas përzgjidhni rubrikën "Përdor". Përfundoni aplikimin dhe shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose kredit. Nëse pagesa kryhet në bankë ose postë, duhet që t'i riktheheni edhe njëherë aplikimit për të ngarkuar mandatpagesën. Ngarkimi i mandatpagesës: Duhet të logoheni në e-Albania dhe të kërkoni shërbimin e	E plotë	Nuk ka

				<p>aplikuar. Nuk do të kryeni aplikim të ri por do të shkoni në fund të formularit, në seksionin “Dërgo mandat-pagesën e një aplikimi të kryer”. Plotësoni të gjitha fushat, numrin e referencës së aplikimit e gjeni edhe tek “Mesazhet e mia”, ngarkoni faturën dhe më pas klikoni “Dërgo”.Pasi të kryeni aplikimin, Ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen, por do të mund të merrni atë me vulë dhe firmë elektronike duke klikuar "Dokumentat e Mia" në profilin Tuaj në e-Albania. Kujdes! Menjëherë pas aplikimit dokumentet që posedoni dhe një kopje të aplikimit duhet t'i dorëzohet përmes Postës shqiptare sha, në adresë të Drejtorisë Vendore të ASHK-së ku është prona juaj.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!</p>		
28	05.07.2022	Kërkesë e paqartë	05.07.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n'a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë. Për cilin institucion po aplikoni?Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!</p>	E refuzuar	Nuk ka
29	05.07.2022	Kërkesë për sqarim në lidhje me përgjigjen e ASHK-së për aplikimin ndarje pasurie	05.07.2022	<p>Përshëndetje Në vijim të komunikimeve, Ju bëjmë me dije se bazuar në përgjigjen e fundit të ardhur nga Drejtoria Vendore e ASHK-së si insitucioni përgjegjës për shërbimin që ju keni kërkuar nevojitet të bëhet një AV0 lidhur me aplikimin fillestar të kryer në muajin Mars 2022 ku janë bërë pagesat për certifikatë, kartelë, hartë. Sic jeni njoftuar dhe nga ASHK për bashkëpronarin tjetër duhet të kryhet aplikimi për certifikatë, kartelë dhe hartë në mënyrë që të gjenerohen këto dokumenta dhe për bashkëpronarin tjetër.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin</p>	E plotë	Nuk ka

				pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
30	05.07.2022	Kërkesë për sqarim në lidhje me kodet e aplikimit të dërguara nga ASHK-ja	06.07.2022	Përshëndetje e nderuar, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se kodet e përmendura nuk janë formularë por shërbime si më poshtë vijon: - L1 (Lëshim çertifikate pronësie) - I4 (Lëshim kopje të fragmentit të hartës kadastrale) - I5 (Lëshim kopje kartele të pasurisë) Për çdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
31	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e rinovimit të lejes së drejtimit të humbur jashtë vendit	06.07.2022	Përshëndetje Z. ...Ju informojmë se lidhur me procedurën që duhet të ndiqet për rinovimin e lejes së drejtimit shqiptare të humbur jashtë Shqipërisë, ju duhet të kryeni veprimet e mëposhtme: Fillimisht duhet të kryeni denoncimin për humbjen e lejes së drejtimit në shtetin ku jetoni. Pasi është bërë ky denoncim, duhet të legalizohet në Shqipëri, në një nga Komisaritet e Policisë. Pas legalizimit të vërtetimit për humbjen e lejes së drejtimit në Komisaritetin e Policisë, duhet të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për t'u pajisur me një leje drejtimi të re. Nëse leja e drejtimit e humbur është lëshuar para Shkurtit 2017, duhet të paraqiteni personalisht për rinovimin e lejes së drejtimit. Nëse leja e drejtimit e humbur është lëshuar nga Shkurti 2017, mund të paraqitet një i afërmi juaj me anë të një prokure të noterizuar ku e autorizoni ju të kryejë shërbim pranë sporteve të DRSHTRR, për t'u pajisur me një dublikatë të lejes së drejtimit. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:	E plotë	Nuk ka

				<ul style="list-style-type: none"> • Dokument identifikimi; • Vërtetimin e denoncimit të humbjes së lejes së drejtimit; Certifikatë mjeksore me fotografi (nëse lejen e drejtimit e dëshironi me afat vlefshmërie të plotë dhe nëse paraqiteni personalisht). <p><i>Tarifa për lejen e re të drejtimit është 3500 lekë, ndërsa për publikatën është 2000 lekë.</i> Informacion të detajuar gjeni në këtë link: https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/humbje-vjedhje-shkaterrim-ose-demtimit-i-lejes-se-drejtimit .Faleminderit,</p>		
32	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e pajisjes me certifikatë nga akti i lindjes për personat e lindur para vitit 2010	06.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije se për të marrë shërbimin e kërkuar mund të paraqiteni pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku është regjistruar akti i lindjes.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
33	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e pajisjes me certifikatë familjare trangu	06.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se certifikata familjare e vitit 1990, konsiderohet si "Certifikatë trangu familjar". Shërbimi "Certifikatë trangu familjar" nuk mundësohet online në portalin e-albania. Për T`u pajisur me Certifikatë trangu familjar, do paraqiteni në zyrën e gjendjes civile të arkivave pranë prefekturës së Qarkut Tuaj. Kjo vlen për të gjitha qarqet, përjashtuar qarku Tiranë.Për Qarkun e Tiranës, procedohet si më poshtë vijon:Për Tirana qytet, do paraqiteni pranë Bashkisë Tiranë për tu pajisur me certifikatë trangu.Për fshatrat, do paraqiteni pranë Prefekturës së qarkut Tiranë.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0	E plotë	Nuk ka

				118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
34	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e aplikimit për pasaportë biometrike dhe ID kartë kur këto të fundit kanë humbur	06.07.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se para se të aplikoni për Pasaportë biometrike dhe Kartë identiteti, duhet të bëni denoncimin e humbjes së dokumentave në Policinë e Shtetit duke aplikuar nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin "Deklarimi i humbjes së dokumenteve të ndryshme" në linkun e mëposhtëm:</p> <p>https://e-albania.noclick_al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14922. Nëse pasaporta dhe karta e identitetit që u kanë humbur janë lëshuar para datës 31 Dhjetor 2011, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun :</p> <p>https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851. Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”. Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet përveç ngarkimit të fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar.</p> <p>Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Pjesë e mesazhit të miratimit do të jetë edhe linku ku duhet të rezervoni datën dhe orën për t’u paraqitur fizikisht me qëllim vijimin e aplikimit. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe Vërtetimin e denoncimit të dokumenteve të humbura, që do të duhet ta dorëzoni pranë</p>	E plotë	Nuk ka

				Zyrës së ALEAT.Në rast se pasaporta aktuale është lëshuar pas datës 1 Janar 2012 duhet vetëm të rezervoni në këtë link https://rezervo.aleat.al/ për datën dhe orën e paraqitjes në sportelin ALEAT. Kujdes! Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim. Nëse nuk jeni i regjistruar në e-albania, do aplikoni për T'u pajisur me kartë identiteti dhe më pas do të bëni regjistrimin për të vazhduar me aplikimin për pasaportë biometrike sipas rasteve të cituara mësipër. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!		
35	05.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e pajisjes me certifikatë martesë të lidhur para vitit 2010 dhe pajisjen me certifikatë trungu familjar	06.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Certifikatë nga akti i martesës" mundësohet online në portalin e-albania për aktet e regjistruara pas vitit 2010. Për aktet e martesave të regjistruara para vitit 2010, duhet të paraqiteni në zyrën e gjendjes civile të arkivave pranë Prefekturës së qarkut Tuaj. Kjo vlen për të gjitha qarqet, përjashtuar qarku Tiranë.Për Qarkun e Tiranës, procedohet si më poshtë vijon: Për Tirana qytet, do paraqiteni pranë Bashkisë Tiranë për të tërhequr certifikatat.Për fshatrat, do paraqiteni pranë Prefekturës së qarkut Tiranë.Për Certifikatat e Trungut Familjar, do të paraqiteni në zyrën e gjendjes civile të arkivave pranë Prefekturës së qarkut Tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
36	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me kalimin e të ardhurave nga barrë lindja	06.07.2022	Përshëndetje e nderuar, Në vijim të kërkesës Tuaj, Ju bëjmë me dije se duhet të na dërgoni ID kartë në mënyrë që më pas ta përcjellim kërkesën tek institucioni përgjegjës për shërbimin e kërkuar.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a	E plotë	Nuk ka

				kontaktioni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
37	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e rinovimit të lejes së drejtimit të humbur jashtë vendit	06.07.2022	<p>Përrshëndetje Z. ...Ju informojmë se lidhur me procedurën që duhet të ndiqet për rinovimin e lejes së drejtimit shqiptare të humbur jashtë Shqipërisë, ju duhet të kryeni veprimet e mëposhtme:Fillimisht duhet të kryeni denoncimin për humbjen e lejes së drejtimit në shtetin ku jetoni. Pasi është bërë ky denoncim, duhet të legalizohet në Shqipëri, në një nga Komisariatet e Policisë. Pas legalizimit të vërtetimit për humbjen e lejes së drejtimit në Komisaratin e Policisë, duhet të paraqiteni pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për t'u pajisur me një leje drejtimi të re. Nëse leja e drejtimit e humbur është lëshuar para Shkurtit 2017, duhet të paraqiteni personalisht për rinovimin e lejes së drejtimit. Nëse leja e drejtimit e humbur është lëshuar nga Shkurti 2017, mund të paraqitet një i afërmi juaj me anë të një prokure të noterizuar ku e autorizoni ju të kryejë shërbim pranë sporteleve të DRSHTRR, për t'u pajisur me një dublikatë të lejes së drejtimit. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Dokument identifikimi; • Vërtetimin e denoncimit të humbjes së lejes së drejtimit; <p>Certifikatë mjeksore me fotografi (nëse lejen e drejtimit e dëshironi me afat vlefshmërie të plotë dhe nëse paraqiteni personalisht).</p> <p><i>Tarifa për lejen e re të drejtimit është 3500 lekë, ndërsa për dublikatën është 2000 lekë.</i> Informacion të detajuar gjeni në këtë link: https://www.dpshttr.al/leje-drejtimi/humbje-vjedhje-shkaterrim-ose-demtimit-i-lejes-se-drejtimit .Faleminderit,</p>	E plotë	Nuk ka

38	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën për pajisje me Certifikatë nga akti i lindjes	07.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal, në llogarinë tuaj dhe identifikohuni, më tej me search kërkonti shërbimin: "Certifikatë nga akti i lindjes)" dhe ju mund të pajiseni online nëse akti i lindjes është regjistruar para vitit 2010. Nëse është pas 2010 nuk mund të pajiseni online por në sportelet e zyrës së gjendjes civile. Por ju mund të aplikoni online shërbimin: "Certifikatë personale (shqip / në gjuhë të huaj)" ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38 dhe më pas përzgjidhni rubrikën "Përdor". Dokumenti do ju shfaqet menjëherë, nëse ju duhet në gjuhë të huaj mjafton të klikoni lart në të djathtë. Nëse dokumenti do të përdoret jashtë vendit duhet noterizuar dhe më pas të legalizohet në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
39	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me detyrimet që i lindin nga dy punësimi.	07.07.2022	Përshëndetje znj....Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar".Sa më sipër gjeni mëposhtë kërkesën e subjektit "...", ku znj. ... interesohet mbi detyrimet që i lindin nga dy punësimi.Lutemi për një përgjigje nga ana	E deleguar	Nuk ka

				juaj.Faleminderit!		
40	06.07.2022	Kërkesë për asistencë për probleme në llogarinë e-albania	07.07.2022	<p>Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju informojmë se nëse nuk keni akses tek emaili me të cilin jeni rregjistruar në portal duhet të dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al :</p> <ul style="list-style-type: none"> • foto të kartës ID • emri i nënës • emri i babait • datëlindja e nënës <p>Specifikoni gjithashtu adresën e re email që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit</p>	E deleguar	Nuk ka
41	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procesin e aplikimit të regjistrimit të krediteve për licencë infermieri	07.07.2022	<p>Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të regjistruar kreditet e përfituara në licencën e ushtrimit të profesionit, nga llogaria Juaj në e-albania duhet të aplikoni shërbimin: “Aplikim për regjistrimin në programin e certifikimit të profesionistëve të shëndetësisë” ose në linkun: https://e-albania.noclick_al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039. Klikoni butonin" Përdor". Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular. Do të njoftoheni me e-mail dhe tek seksioni “Dokumentet e mia” në e-Albania për regjistrimin. Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit është 10 ditë.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!</p>	E plotë	Nuk ka
42	06.07.2022	Kërkesë për asistencë për probleme në	07.07.2022	<p>Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për t`u pajisur me një password të ri, pasi nuk kanë funksionuar kodet që u janë gjeneruar në numrin e</p>	E plotë	Nuk ka

		Ilogarinë e-albania		<p>telefonit apo në email-in Tuaj, duhet të veproni si më poshtë:Nga adresa Juaj email dërgoni këto të dhëna në adresën helpdesk@e-albania.al :</p> <ul style="list-style-type: none"> • foto të kartës ID • emri i nënës • emri i babait • datëlindja e nënës <p>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!</p>		
43	06.07.2022	Kërkesë për informacion lidhje me procedurën e lidhjes së martesës	07.07.2022	<p>Përsëritet, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të kryeni shpalljen e martesës. Procedura për të bërë shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë është si më poshtë vijon:Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesë.Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; • certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martesë”; • fotokopje e dokumentit të identifikimi <p>Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditore nga e nesërmja e shpalljes, secili nga bashkëshortët e</p>	E plotë	Nuk ka

				ardhshëm pajiset me dokumentin certifikatë lindje për lidhje martesë. Në ditën e caktuar për lidhjen e martesës duhet të jenë të pranishëm dhe dy dëshmitarë. Lidhur me pyetjen tuaj , ju bëjmë me dije se shpallja e martesës bëhet në të dyja gjendjet civile duke qene prezent te dy. Ne mungese te njerit nga partneret duhet te pajise me prokure me vule apostile Juve ose nje person te trete per te bere shpalljen ne emer te tij.Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanal in informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte ne fashen orare 08.00 – 19.00.Faleminderit!		
44	06.07.2022	Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e pajisjes me dokument që tregon ndryshimin e gjeneraliteteve	07.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është e pa plotë. Nuk keni referuar se me ç`lloj akti keni bërë ndryshimin e gjeneraliteteve.Nëse ndryshimi i gjeneraliteteve ka ardhur si rezultat i Aktit të Martesës, dokumenti që e vërteton këtë është Certifikatë nga Akti i Martesës. Nëse gjeneralitetet i keni ndryshuar me kërkesën Tuaj pranë Gjendjes Civile, vërtetimin do t`Jua lëshojë Gjendja Civile.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit!	E plotë	Nuk ka
45	07.07.2022	Kërkesë e paqartë mbi AMTP	07.07.2022	Përshëndetje, Në vijim të emailit tuaj, Ju lutem n`a dërgoni një kërkesë më të plotë që të kemi mundësinë tju informojmë.Për cdo pyetje ose paqartësi n`a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanal in e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!	E refuzuar	Nuk ka
46	07.07.2022	Kërkesë për kontrollimin e të dhënave të vendlindjes së fëmijë	07.07.2022	Përshëndetje,Në vijim të pyetjes suaj, ju bëjmë me dije si më poshtë:Për të marrë shërbimin e kërkuar mund të aplikoni në portalin e-Albania. Hyni në portal, në llogarinë tuaj dhe identifikohuni, më tej me search kërkoni	E refuzuar	Nuk ka

				shërbimin: "Certifikatë personale (shqip / në gjuhë të huaj)" ose në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=38 dhe më pas përzgjidhni rubrikën "Përdor". Më pas ju duhet të përzgjidhni opsionin për fëmijën nën 16 vjec. . Dokumenti do ju shfaqet menjëherë dhe ju mund të kontrolloni të dhënat personale. Nëse dokumenti ka gabime duhet të paraqiteni pranë sporteleve të gjendjes civile ku është kryer regjistrimi i fëmijës.Për cdo pyetje ose paqartësi n'a kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalën e ri të komunikimit (online chat) nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit!		
47	23.06.2022	Kërkesë për informacion në kuadër të projektit për monitorimin e reformës në administratën publike, që është duke zbatuar Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetesim mbi hartimin e VKM nr. 252, datë 29.04.2022 dhe qëndrimin e ADISA-s	05.07.2022	Në përgjigje të kërkesës tuaj ardhur nëpërmjet e-mail-it më datë 23.06.2022 me objekt "Kërkesë për Informacion", protokolluar në ADISA me nr. 534 Prot, datë 24.06.2022, ju informojmë se Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është krijuar dhe organizohet sipas ligjit 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", i cili ka në fokus ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet sporteleve fizike. Me Urdhërin e Kryeministrit nr. 158, datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020", u vendos që ADISA do të asistonte qytetarët, në sportel, në aplikimin e shërbimeve në portalin e-albania.Në gjithë veprimtarinë e saj, ADISA ka vendosur standarde në mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike.Në kontekstin e pyetjeve që ju ngrini mbi temën e mbylljes së sporteleve, dëshirojmë t'Ju bëjmë me dije disa informacione tashmë të njohura dhe të bëra publike: <ul style="list-style-type: none"> • Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka si kryefjalë të mandatit të saj të 3-të qeverisë togfjalëshin 	E plotë	Nuk ka

